



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

REAGIM PUBLIK

Përmes rrjeteve sociale Oda e Mjekëve të Kosovës është njoftuar për kërcënimin e bërë ndaj specialistit të mikrobiologjisë Prof. Dr. Lul Raka lidhur me deklaratën e tij për mundësinë e rrezikut i cili mund të krijohet nga rritja e numrit të rasteve me virusin Covid-19. Në kuadër të mesazhit kërcënues përveç mjekut është kërcënuar edhe familja e tij.

Oda e Mjekëve të Kosovës shpreh shqetësim të thellë rreth këtij mesazhi kërcënues i cili është dërguar tek një profesionist shëndetësor dhe atë ndër më meritorët në luftën kundër pandemisë Covid-19. Shqetësues është edhe vetë fakti se përkrah kontributit të dhënë në një kohë kur vendi ka më së shumti nevojë për profesionistë të lëmive specifike, të tillë si Prof. Dr. Raka, një profesionisti të tillë i pamundësohet dhënia e kontributit të tij duke e kërcënuar për të drejtën themelore të njeriut, të drejtën në jetë.

Ky kërcënim duhet të jetë shqetësim jo vetëm për komunitetin mjekësor, por për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, shëndeti i të cilëve është në duar të profesionistëve tanë shëndetësor, të cilët po bëjnë të pamundurën në luftën kundër virusit edhe duke marrë parasysht kushtet e punës.

Përderisa nga Bashkimi Evropian vlerësohet lartë me çmime, në vendin tonë një profesionist shëndetësor kërcënohet në forma të rënda, së bashku me familjen e tij gjë e cila është e papranueshme. Andaj, Oda e Mjekëve të Kosovës dënon ashpër një kërcënim të tillë dhe i bënë thirrje institucioneve kompetente që të fillojnë veprimet e menjëhershme hetimore dhe ndjekjen penale të formave të tilla të kërcënimeve të cilat krijojnë pasiguri jetësore ndaj profesionistëve shëndetësor të cilët lënë anash çdo gjë, përfshirë këtu edhe familjet e tyre, vetëm e vetëm për të qenë të gatshëm për t'i shërbyer vendit në situata të vështira siç gjendemi tani në kohë pandemie.

OMK do të angazhohet maksimalisht rreth trajtimit serioz lidhur me sigurinë e mjekëve në vendin e tyre të punës dhe mbrojtjen e dinjitetit profesional të mjekut në shoqëri.

PRISHTINË, 10 qershor 2020